



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 10453 Prot.  
11

Tiranë, më 24.10.....2018



MIRATOHET  
MINISTËR

LINDITA NIKOLLA

**PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETERORE**

**LËNDA : QYTETARI DHE PSIKOLOGJI**

**(me zgjedhje)**

**VITI SHKOLLOR : 2018-2019**

**Tiranë, 2018**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

---

## **PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE**

**(Provim me zgjedhje për gjimnazet)**

**LËNDËT:**

**QYTETARIA  
dhe  
PSIKOLOGJIA**

**Koordinator: Astrit Dautaj; Esion Zgjana**

**Viti shkollor 2018-2019**

**TIRANË, SHTATOR 2018**

## 1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndët qytetaria dhe psikologjia, përfshin konceptet më të rëndësishme të lëndës, si dhe njohuritë dhe shprehjet themelore që synohen në këto lëndë. Ky program është bazuar në programet ekzistuese të lëndës qytetaria dhe psikologjia, të zhvilluara respektivisht në klasën e 10-të dhe të 12-të të shkollave të mesme të përgjithshme.

Programi orientues për provimin me zgjedhje për lëndët qytetaria dhe psikologjia, i vlefshëm për provimet me zgjedhje në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2018 - 2019, përbën një dokument të vlefshëm për shkollën e mesme, për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e konsultimit ose të vlerësimit për provimet e Maturës Shtetërore.

1. Programi orienton **nxënësit** për përvetësimin e materialeve kyçe mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndëve qytetaria dhe psikologjia si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
2. Programi përmban informacionin e nevojshëm orientues për **mësuesit** e këtyre lëndëve që do të përgatisin maurantët për provimin me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
3. Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga **specialistët e vlerësimit**, të përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndëve qytetaria dhe psikologjia si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesuara.

Kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe të tezës së provimit të lëndës qytetaria të cilët **nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program**. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit të përmbajnë njohuri dhe koncepte të parashikuara në programin lëndor dhe të trajtuara në tekstet e mësimore.

**Mësuesit** që do të përgatisin nxënësit për provimin e lëndëve qytetaria dhe psikologjia t'i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk trajtohen në tekstin e përzgjedhur, por që përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndëve qytetaria dhe psikologjia të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve kyçe dhe të aftësive intelektuale të përcaktuara në program.

### **Kujdes!**

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektiv të caktuar të programit, atëherë **mësuesi** i lëndës, **që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të përcaktuar**.

**Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!**

## 1.1 UDHËZIMI I VEÇANTË

Testi në provimin me zgjedhje të maturës shtetërore në lëndët qytetaria dhe psikologjia do të ndërtohet në bazë të kërkesave dhe objektivave të programit të këtyre lëndëve.

Testi **synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e qytetarisë**, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

- a. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t'u testuar në këtë provim.
- b. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e qytetarisë në shkollë, të tilla si:
  1. aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët i aftësive intelektuale).
  2. aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale).
  3. aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

### 1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (p. sh., ministrat) ose jo të prekshme (p.sh., koncepte, të tilla si: drejtësia, barazia etj.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.
- **Të përshkruash** do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

### 2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- Të **shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p.sh.: shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.
- Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

### 3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- **Të vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.

- **Të marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.
- **Të mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështesin atë qëndrim ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

### Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

### Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, të cilat mund të maten/të vlerësohen me anë:

1. të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilat nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;
2. të testeve me përgjigje të kufizuara;
3. të testeve me përgjigje të zgjeruara.

#### 1. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, janë, për shembull, aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;
- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

#### 2. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

**3. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara, janë, për shembull, aftësitë:**

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

# I. QYTETARIA

## Rezultatet e pritshme të programit të lëndës qytetaria sipas temave

<p><b>Tema 1: Ligji</b></p> <p>Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë.</p> <p>Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri.</p>	
<p><b>Ligji</b>  <b>Orë të sugjeruara: 6</b>  <b>Rezultatet e pritshme të të nxënit</b></p>	
<p><b>Njohuritë</b></p>	<p><b>Shkathësitë dhe aftësitë</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji, kuptimi, qëllimet, natyra dhe funksionet e tij.</li> <li>• Rëndësia e ligjit në shoqëri</li> <li>• Veprimi i ligjit në kohë dhe hapësirë.</li> <li>• Ligji dhe vlerat</li> <li>• Rëndësia e marrjes parasysh e vlerave morale, politike, sociale dhe ekonomike në hartimin, kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e ligjeve</li> <li>• Llojet e ligjeve</li> <li>• Larmia e marrëdhënieve shoqërore dhe juridike dhe kuptimi për ligjet si rregullatorë të marrëdhënieve juridike në fushat përkatëse.</li> <li>• Zbatimi i ligjit</li> <li>• Rëndësia e zbatimit të ligjit në shoqëri</li> <li>• Pasojat e zbatimit/moszbatisimit të</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon qëllimin e ligjit;</li> <li>• diskuton për funksionet dhe natyrën e ligjit në shoqëri;</li> <li>• identifikon dhe vlerëson pasojat e veprimit apo mosveprimit të ligjit në shoqëri;</li> <li>• argumenton me shembuj nga jeta e përditshme domosdoshmërinë e ligjit për shoqërinë;</li> <li>• identifikon dhe diskutojnë për vlerat që qëndrojnë në themel të ligjeve;</li> <li>• shpjegon domosdoshmërinë e llojeve të ndryshme të ligjit në shoqëri;</li> <li>• demonstron aftësinë të vlerësojnë vlerat në qëndrimin ndaj ligjeve të caktuara;</li> <li>• identifikon raste të shkeljeve të ndryshme ligjore dhe të diskutojë për pasojat e tyre për veten, familjen dhe mjedisin ku jeton; evidenton dhe analizon faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij ndaj zbatimit të ligjit.</li> </ul>

<p>ligjit për individin dhe shoqërinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faktorët që ndikojnë në cilësinë e zbatimit të ligjit</li> </ul>	
<p><b>Tema 2: Kushtetuta e Shqipërisë</b>          Nxënësi njihet me thelbin e Kushtetutës si Lligji themeltar i shtetit, si burim i legjislacionit dhe kriter i vlerësimit të tij.          Ai njihet me parimet themelore mbi të cilat ngrihet qeverisja demokratike, të cilat janë edhe standardet mbi bazën e të cilave gjykohet dhe vlerësohet realiteti demokratik në Shqipëri.</p>	
<p><b>Kushtetuta</b>  <b>Orë të sugjeruara: 5 orë</b>  <b>Rezultatet e të nxënit</b></p>	
<p><b>Njohuri</b></p>	<p><b>Aftësi</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtetuta - Ligji më i lartë i shtetit</li> <li>• Kushtetuta si burim i legjislacionit</li> <li>• Kushtetuta dhe forma e shtetit</li> <li>• Kushtetuta dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut</li> <li>• Kushtetuta dhe struktura e organeve të shtetit dhe kompetencat e tyre</li> <li>• Kushtetuta, ndarja dhe balancimi i pushteteve</li> <li>• Disa nga parimet bazë që qëndrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë</li> <li>• Kuptimi i parimit të barazisë</li> <li>• Raporti ndërmjet lirisë dhe barazisë</li> <li>• Barazia formale dhe barazia reale</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan rolin e Kushtetutës si Ligji themeltar i shtetit;</li> <li>• përshkruan parimet kryesore të mishëruara në Kushtetutën shqiptare;</li> <li>• argumenton rëndësinë e mbështetjes në parimet e Kushtetutës për hartimin dhe zbatimin e ligjeve;</li> <li>• argumenton domosdoshmërinë dhe rëndësinë e përmirësimit të kushtetutës në përputhje me dinamizmin dhe veçoritë e jetës ekonomike, sociale e politike të shoqërisë.</li> </ul>
<p><b>Tema 3: Të drejtat e njeriut</b>          Nxënësit i jepet mundësia të hyjë në botën e të drejtave të njeriut, si një ndër treguesit kryesorë të një shoqërie demokratike. Ata mësojnë të drejtat e njeriut, rëndësinë, kufizimet dhe ndërlidhjen ndërmjet tyre</p>	
<p><b>Të drejtat e njeriut</b>  <b>Orë të sugjeruara: 10 orë</b>  <b>Rezultatet e të nxënit</b></p>	
<p><b>Njohuri</b></p>	<p><b>Aftësi</b></p>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ç’janë të drejtat e njeriut</li> <li>• Kategoritë e ndryshme të të drejtave të njeriut</li> <li>• Të drejtat civile e politike</li> <li>• Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore</li> <li>• Të drejtat e mjedisit dhe të zhvillimit</li> <li>• Cilat janë të drejtat që duhet të përfshihen në kartën e të drejtave</li> <li>• Pakti Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore dhe Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike</li> <li>• Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut</li> <li>• Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut</li> <li>• Të drejtat në konflikt</li> <li>• Kufizimi i të drejtave</li> <li>• Ndërlidhja e të drejtave</li> <li>• Disa nga të drejtat themelore të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Shqipërisë</li> <li>• E drejta për të jetuar dhe për ruajtjen e integritetit fizik dhe moral të individit</li> <li>• E drejta e shprehjes. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë</li> <li>• E drejta për t’u informuar</li> <li>• E drejta për t’u martuar dhe patur familje</li> <li>• E drejta për t’u arsimuar</li> <li>• E drejta për punë</li> <li>• E drejta për t’u organizuar</li> <li>• E drejta për të gëzuar një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët</li> <li>• E drejta për një proces të rregullt gjyqësor</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• jep një përkufizim të të drejtave të njeriut;</li> <li>• dallon lidhjen e të drejtave të njeriut me nevojat bazë të njeriut;</li> <li>• shpjegon lidhjen e të drejtave të njeriut me vlerat dhe interesat e tyre jetësore të sotme dhe të perspektivës;</li> <li>• interpreton konceptimet e ndryshme për të drejtat e njeriut dhe shpreh qëndrimin e tij vetjak lidhur me to;</li> <li>• përshkruan tiparet kryesore të të drejtave të njeriut dhe shpjegon rëndësinë e secilit prej tyre;</li> <li>• përshkruan përmbajtjen e disa prej dokumenteve themelore të të drejtave të njeriut dhe të institucioneve kryesore evropiane të të drejtave të njeriut;</li> <li>• dallon kategoritë kryesore të të drejtave sipas legjislacionit ndërkombëtar;</li> <li>• përshkruan dhe argumenton rëndësinë e kufizimit ligjor të të drejtave të njeriut dhe sferën dhe kushtet e kufizimit të tyre;</li> <li>• përshkruan, me shembuj nga jeta e përditshme, lidhjen e të drejtave të njeriut dhe rëndësinë e saj për realizimin e tyre tërësor;</li> <li>• identifikon dhe shpjegon raste të të drejtave në konflikt dhe shprehet për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet të drejtave.</li> </ul>
--	--

**Tema 4: Arsimimi**

Shkolla luan një rol të pazëvendësueshëm për rritjen dhe edukimin e fëmijës nga pikëpamja shoqërore dhe kulturore. Ajo i përgatit fëmijët, jo vetëm për të hyrë me këmbë të sigurt në

botën e të rriturve, por edhe që t'i aftësuar të vetëzhvillohen e t'u përshtaten më mirë ndryshimeve të botës.

Orë të sugjeruara 6 orë

**Arsimimi**  
**Orë të sugjeruara:7**  
**Rezultatet e të nxënës**

Njohuritë	Aftësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkolla, funksioni i saj</li> <li>• Rëndësia e arsimimit</li> <li>• Arsimimi si e drejtë themelore</li> <li>• Konventa për të drejtat e fëmijës</li> <li>• Kushtetuta e Shqipërisë për arsimin</li> <li>• Ligji për arsimin parauniversitar</li> <li>• Si realizohet e drejta për arsimim</li> <li>• Institucionet shkollore, roli dhe përgjegjësia e tyre për të garantuar të drejtën për arsim për të gjithë</li> <li>• Çfarë duhet të studiojmë në shkollë dhe përse?</li> <li>• Cilësia dhe barazia në arsim</li> <li>• Si garantohen shanse të barabarta për të gjithë nxënësit</li> <li>• Si garantohet cilësia e shërbimit arsimor për të gjithë</li> <li>• Kush duhet të vendosë për arsimimin tim?</li> <li>• Reformat arsimore, arsyet e reformave dhe zbatimi i tyre</li> <li>• Pjesëmarrja e të rinjve në projektimin e reformave arsimore</li> <li>• Shkolla si një shoqëri multietnike ose multikulturore</li> <li>• Problemet e shkollës sot.</li> <li>• A u shërben shkolla interesave të nxënësve? Çfarë duhet të sigurojë shkolla për të përmbushur këto interesa</li> <li>• Analfabetizmi, analafabetizmi funksional</li> <li>• Standardet e shkollës</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• argumenton rëndësinë e arsimimit për jetën e secilit;</li> <li>• argumenton të drejtën për arsim si e drejtë themelore;</li> <li>• argumenton rëndësinë e mbrojtjes me ligj të të drejtës për arsimim;</li> <li>• përshkruan disa nga realizimet e ligjit shqiptar për arsimin parauniversitar;</li> <li>• përshkruan ndryshimet e shkollës në vite;</li> <li>• përshkruan mundësitë që ofron arsimimi në vendin tonë;</li> <li>• dallon rolin e shkollës dhe të mësuesve;</li> <li>• tregon disa nga problemet me të cilat përballet arsimi dhe shkolla jonë sot;</li> <li>• përdor njohuritë dhe mjetet e tjera që ofron shkolla për të bërë zgjedhje për vazhdimësinë e arsimimit të tij;</li> <li>• mbledh fakte e të dhëna për problemet e shkollës e bën interpretimin e tyre;</li> <li>• parashikon pasoja të ndryshme të funksionet e shkollës të qëndrimeve, politikave ose ligjeve të ndryshme.</li> </ul>

**Tema 5: Shëndeti**

Shëndeti është një e drejtë themelore e njeriut. Ruajtja e tij nga rreziqet dhe “armiqtë” e shumtë duhet të jetë përparësi jo vetëm e individëve që e kanë, por edhe e shtetit. Njohja e tij si e drejtë dhe pranimi i detyrimeve për ruajtjen dhe mirëqënien e tij duhet të jetë detyrim i shtetit dhe i shoqërisë. Në këtë kuadër shkolla duhet të luajë rolin kryesor të informimit në lidhje me shëndetin, rreziqet, përkujdesjet etj.

**Shëndeti****Orë të sugjeruara: 6****Rezultatet e pritshme të nxënësve**

<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shëndeti si një e drejtë themelore</li> <li>• Shëndeti në dokumentet e të drejtave të njeriut dhe në legjislacionin shqiptar</li> <li>• Mbrojtja e shëndetit në vendin tonë</li> <li>• Parandalimi dhe informacioni</li> <li>• Masat dhe veprimtaritë vetjake në mbrojtje të shëndetit.</li> <li>• Rreziqet e shëndetit dhe siguria.</li> <li>• Disa nga mjediset jetësore dhe rreziqet që shoqërojnë veprimtarinë tonë të përditshme</li> <li>• Cilët janë disa nga armiqtë kryesorë të shëndetit?</li> <li>• Legjislacioni shqiptar në mbrojtje të shëndetit kundër armiqve të tillë (sida, alkoli, droga, duhani, doping etj.).</li> <li>• Disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin dhe qëndrimet etike për to.</li> <li>• Mbështetja me legjislacionin përkatës</li> <li>• Detyrimet individuale dhe shoqërore për shëndetin</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• jep një përkufizim për shëndetin</li> <li>• vlerëson shëndetin si një të drejtë njerëzore dhe tregon mbrojtjen e tij në dokumentet e të drejtave të njeriut;</li> <li>• argumenton domosdoshmërinë e mbrojtjes me ligj të shëndetit;</li> <li>• tregon si legjislacioni shqiptar e mbron shëndetin;</li> <li>• argumenton rëndësinë e mbrojtjes paraprake të shëndetit dhe e parandalimit të veprimit të faktorëve që e dëmtojnë atë;</li> <li>• argumenton rëndësinë e informimit publik për çështjet e shëndetit;</li> <li>• identifikon dhe përshkruan disa nga problemet e sotme në lidhje me shëndetin dhe llojet e tyre;</li> <li>• diskuton për shkaqet kryesore të disa prej problemeve kryesore që lidhen me shëndetin;</li> <li>• dallon disa nga shtresat e pafavorizuara të shoqërisë dhe problemet e tyre që lidhen me shëndetin;</li> <li>• tregon si ligji shqiptar mbron shëndetin e të gjitha shtresave të shoqërisë;</li> <li>• rendit disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin dhe shpreh qëndrimin e tij për to;</li> <li>• përcakton dhe diskuton për detyrimet individuale dhe shoqërore për mbrojtjen e shëndetit.</li> </ul>

**Tema 6: Mjedisi**

Mjedisi përbën burimin themelor për jetën në tokë. Megjithatë ai është rrezikuar dhe rrezikohet vazhdimisht nga veprimtaria njerëzore. Brezat e ardhshëm do të trashëgojnë gjithnjë e më pak nga mjedisi i sotëm, pasi ai shfrytëzohet pa kriter nga brezat e sotëm. Edukimi i të

rinjve me përgjegjësinë e ruajtjes dhe zhvillimit të tij është një përparësi.	
<b>Mjedisi</b> <b>Orë të sugjeruara: 6</b> <b>Rezultatet e pritshme të të nxënit</b>	
<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekologjia</li> <li>• Rreziqet për planetin</li> <li>• Mjedisi i shëndetshëm si një e drejtë njerëzore</li> <li>• Përpjekjet e njerëzimit për të ruajtur planetin</li> <li>• Roli i shkencës dhe i teknologjisë për ruajtjen e planetit</li> <li>• Si mund të ruajmë planetin</li> <li>• Energjia</li> <li>• Kontradiktat e zhvillimit</li> <li>• Zhvillimi i qëndrueshëm</li> <li>• Politikat evropiane për ruajtjen e mjedisit</li> <li>• Legjislacioni shqiptar për ruajtjen e mjedisit</li> <li>• Ruajtja dhe zhvillimi i mjedisit është përgjegjësi për të gjithë.</li> <li>• Si të jetojmë në një mjedis të shëndetshëm dhe për një mjedis të shëndetshëm</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjego lidhjen ndërmjet ruajtjes së mjedisit dhe ruajtjes së vetë njeriut;</li> <li>• vlerëson mjedisin e shëndetshëm si një të drejtë të njeriut;</li> <li>• tregon si legjislacioni shqiptar mbron mjedisin;</li> <li>• dallon rreziqet me të cilat përballet sot planeti ynë.</li> <li>• identifikon disa nga format e ndotjes së mjedisit në Shqipëri;</li> <li>• rendit disa nga llojet kryesore të ndotjes së mjedisit në bashkësinë ku jeton;</li> <li>• bën kërkime të pavarura ose në grup për mënyrën se si trajtohet mjedisi në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ose qendrore;</li> <li>• përkufizon me fjalët e tij termin zhvillim i qëndrueshëm;</li> <li>• shpjegon rëndësinë e marrjes parasysh të pasojave të veprimeve dhe sjelljeve tona mjedisore për brezat e ardhshëm dhe për ardhmërinë në përgjithësi;</li> <li>• tregon me shembuj që mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi individuale;</li> <li>• parashikon disa nga pasojat që kanë për brezat e ardhshëm, zgjedhjet që bëjnë individët, grupet ose shteti.</li> </ul>
<b>Tema 7: Konsumatori</b>	
<b>Konsumatori</b> <b>Orë të sugjeruara: 8</b> <b>Rezultatet e pritshme të të nxënit</b>	
<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• E drejta e konsumatorit dhe përmbajtja e saj</li> <li>• Çdo të thotë të jesh konsumator kur blen, pas blerjes.</li> <li>• Faktorët që ndikojnë në sjelljen e konsumatorit</li> <li>• Zgjedhja e konsumatorit, faktorët</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan tiparet kryesore të ligjit mbi konsumatorin;</li> <li>• të përcakton përmbajtjen e konceptit konsumator dhe të përshkruajë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit;</li> <li>• përshkruan disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet</li> </ul>

<p>që e përcaktojnë atë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrata. Kuptimi i kontratës në ligjin mbi konsumatorin, elementet dhe kushtet e lidhjes së saj. Llojet kryesore të kontratave, pasojat e kontratës, prishja e kontratës dhe pasojat e prishjes së saj</li> <li>• Garancia si pjesë e kontratës, përmbajtja e saj. Si lexohet një garanci.</li> <li>• Reklama dhe konsumatori</li> <li>• Procedurat e mbrojtjes pas blerjes</li> </ul>	<p>e konsumatorit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstron aftësi, shmang dhe zgjidh probleme të thjeshta si konsumator;</li> <li>• analizon dhe përshkruan elementet kryesore të kontratës së shitblerjes;</li> <li>• shpjegon elementet dhe rëndësinë e garancisë për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorit;</li> <li>• përshkruan funksionet e reklamës dhe analizon raste të keqpërdorimit të saj si shkelje e interesave dhe të drjtave të konsumatorit;</li> <li>• identifikon organizata që punojnë e luftojnë për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit.</li> </ul>
---	--

### **Tema 8: Puna dhe e drejta e punës**

E drejta e punës sanksionohet në Kushtetutë dhe mbrohet nga legjislacioni i veçantë i cili përmbledhet dhe kodifikohet në Kodin e punës.

Puna është mjedisi dhe mjeti për realizimin e individit, por që shpeshherë është edhe mjedisi i abuzimit me të. Njohja e legjislacionit të punës është i rëndësishëm për mbrojtjen e individëve si punëmarrës.

### **Puna dhe e drejta e punës**

#### **Orë të sugjeruara: 6**

#### **Rezultatet e pritshme të të nxënit**

<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtetuta për të drejtën e punës</li> <li>• Kodi i Punës dhe mbrojtja e interesave të punonjësit</li> <li>• Roli i legjislacionit të punës në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve</li> <li>• Të drejtat e punonjësve. Mënyrat e mbrojtjes së tyre</li> <li>• Kontrata e punës</li> <li>• Kuptimi i kontratës së punës. Kushtet e lidhjes së kontratës së punës. Marrëveshja ndërmjet palëve. Shkaku i kontratës, objekti i saj. Forma e kontratës. Llojet e kontratave të punës</li> <li>• Kushtet e punës. Kuptimi i</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• jep një përcaktim të termave punë dhe punoj;</li> <li>• rendit lloje të ndryshme punësh;</li> <li>• dallon faktorët kryesorë që mundësojnë një proces prodhues;</li> <li>• tregon përgjegjësinë e shtetit për punën.</li> <li>• rendit të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën;</li> <li>• rendit disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë;</li> <li>• përshkruan tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri;</li> <li>• përshkruan disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të;</li> <li>• diskuton për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë</li> </ul>

<p>kushteve të punës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtja në punë. Detyrimet e punëmarrësit për të siguruar mbrojtjen në punë. Mbrojtja e veçantë e të miturve në punë. Koha e punës. Koha e lejes dhe pushimit</li> <li>• Zgjidhja e kontratës dhe humbja e punës. Kuptimi i zgjidhjes së kontratës. Rastet e zgjidhjes së kontratës. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme.</li> <li>• Zgjidhja e kontratës për shkaqe të arsyeshme</li> <li>• Afati i zgjidhjes së kontratës</li> <li>• Sigurimi shoqëror. Kuptimi mbi sigurimin shoqëror. Sigurimi shoqëror në legjislacionin shqiptar. Sigurimi shoqëror dhe interesat aktuale dhe perspektive të punonjësve</li> <li>• Sigurimi shoqëror dhe realiteti shqiptar</li> </ul>	<p>Shqipërisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mbledh fakte e të dhëna për problemet e punës së fëmijëve e bën interpretimin e tyre;</li> <li>• parashikon pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës qëndrime ose praktika të caktuara që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në shoqëri;</li> <li>• përshkruan disa nga të drejtat e tij në punë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre;</li> <li>• diskuton për rëndësinë e legjislacionit të punës për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të punonjësve;</li> <li>• jep përkufizimin e kontratës sipas legjislacionit dhe përshkruan elementet e saj;</li> <li>• rendit disa nga hapat e domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të tij në punë.</li> </ul>
---	---

**Tema 9: Siguria në rrugë**

**Siguria në rrugë  
Orë të sugjeruara: 8  
Rezultatet e pritshme të të nxënit**

<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi rrugor</li> <li>• Sinjalet rrugore dhe kuptimi i tyre. Llojet e sinjaleve rrugore.</li> <li>• Këmbësorët</li> <li>• Qarkullimi i këmbësorëve</li> <li>• Kalimi i rrugës</li> <li>• Kalimi i këmbësorëve në kryqëzime</li> <li>• Përdorimi i mjeteve publike</li> <li>• Qarkullimi i ciklistëve</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan qëllimin e kodit rrugor dhe funksionet kryesore të tij;</li> <li>• përcakton sinjalet kryesore rrugore që rregullojnë qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave;</li> <li>• përcakton sjelljen e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave në rrugë në raport me përdoruesit e tjerë të rrugës;</li> <li>• merr vendim për lëvizjen e tij në rrugë në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qarkullimi i biçikletave.</li> <li>• Qëndrimi në karrexhatë</li> <li>• Kthesat dhe ndryshimi i drejtimit</li> <li>• Kryqëzimet dhe rregullat e përparësisë</li> <li>• Shpejtësia dhe distanca e sigurisë</li> <li>• Parakalimet</li> <li>• Qarkullimi i motoçikletave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• gjykon për rregullsinë ose parregullsinë e lëvizjes së përdoruesve të rrugës;</li> <li>• vlerëson dhe parashikon pasojat e moszbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor për individët dhe shoqërinë etj.</li> </ul>
---	---

### **Tema 10: E drejta për informim dhe ligji për median**

Informacioni është thelbësor për çdo shoqëri demokratike.

Ai është e drejtë dhe detyrim. Ai është pushtet dhe për këtë arsye, shpeshherë përdoret në mënyrë të padrejtë, në dëm të interesave të individëve, grupeve ose shoqërisë. Si i tillë ai duhet të jetë vazhdimisht në qendër të shikimit kritik.

#### **E drejta për informim dhe ligji për median**

**Orë të sugjeruara:**

**Rezultatet e pritshme të nxënësve**

<b>Njohuri</b>	<b>Aftësi</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informimi dhe rëndësia e tij</li> <li>• Informimi dhe mjetet e tij.</li> <li>• Mjetet tradicionale të informimit</li> <li>• Mjetet e reja të informimit</li> <li>• Të përditshmet</li> <li>• Gjuha e informimit dhe e pamjeve</li> <li>• Media dhe mitet e saj (mitet e TV)</li> <li>• TV dhe ligji për të miturit</li> <li>• Interneti, avantazhet dhe disavantazhet. Rreziqet</li> <li>• Informacioni në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut</li> <li>• E drejta e informimit në Kushtetutën e Shqipërisë</li> <li>• Legjislacioni shqiptar për median e shkruar dhe atë elektronike</li> <li>• E drejta e informimit dhe abuzimet me të</li> <li>• Disa nga problemet bashkëkohore në lidhje me informimin</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• jep një përshkrim të konceptit informacion;</li> <li>• përshkruan mjetet kryesore tradicionale dhe të reja të informacionit;</li> <li>• flet për mundësitë dhe kufizimet e informacionit;</li> <li>• shpjegon rëndësinë e vlerësimit kritik të informacionit;</li> <li>• shpreh qëndrimin e tij për lirinë e medias dhe për ligjin shqiptar që lidhet me të drejtën e informacionit;</li> <li>• mbledh fakte e të dhëna për problemet e informimit të rinjve e bën interpretimin e tyre;</li> <li>• parashikon pasojat të ndryshme të qëndrimeve të medias në jetën e fëmijës.</li> </ul>

### **Tema 11: Bashkëjetesa në komunitetet**

Bashkëjetesa në bashkëpronësi kërkon detyrime nga të gjithë anëtarët e saj. Shpeshherë këto

detyrime nuk respektohen dhe kjo krijon probleme të mëdha për jetesën e përbashkët. Njohja me ligjin dhe detyrimet dhe të drejtat e jetesës në bashkëpronësi do të ndihmojë në zgjidhjen afatgjate të këtyre problemeve dhe do të përmirësojë jetën e anëtarëve të saj

### Bashkëjetesa në komunitet (bashkëpronësi)

Orë të sugjeruara: 3

#### Rezultatet e pritshme të të nxënit

Njohuri	Aftësi
<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkëpronësia dhe bashkëpronarët</li> <li>Asambleja e bashkëpronarëve - detyrat e saj</li> <li>Rregullorja e asamblesë, marrja e vendimeve në bashkëpronësi</li> <li>Komuniteti (pallati, lagja, bllok pallatesh) dhe detyrat e tij</li> <li>Komuniteti dhe problemet e tij sot</li> <li>Detyrimet e përbashkëta</li> <li>Vështirësitë e përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>përkufizon konceptet “bashkëjetesë në bashkëpronësi” dhe “bashkëpronarë”;</li> <li>përshkruan detyrimet e përbashkëta të anëtarëve të komunitetit;</li> <li>dallon disa prej problemeve kryesore që ndeshen sot në bashkëjetesën në komunitet;</li> <li>eksploron problemet që ndeshen në komunitetin e tij dhe analizon shkaqet kryesore të problemeve që lidhen me bashkëjetesën në këtë komunitet;</li> <li>përshkruan ligjin për bashkëjetesën në komunitet, funksionet, nenet, pasojat e zbatimit dhe të moszbatimit të tij.</li> </ul>

## PESHA E TEMATIKAVE

Nr.	Tematika	Pesha (në përqindje)
1.	Ligji (6 orë)	8%
2.	Kushtetuta (5 orë)	7%
3.	Të drejtat e njeriut (10 orë)	14%
4.	Arsimimi (7 orë)	11%
5.	Shëndeti (6 orë)	8%
6.	Mjedisi ( 6 orë)	8%
7.	Konsumatori (8 orë)	12 %
8.	Puna dhe e drejta e punës ( 6 orë)	8%
9.	Siguria në rrugë (8 orë)	12%
10.	E drejta për informim dhe ligji për medien (6 orë)	8%
11.	Bashkëjetesa në komunitet ( 3 orë)	4%
<b>Totali:</b>		<b>100%</b>



## PSIKOLOGJIA

### Rezultatet e të nxënit sipas tematikave të lëndës

<p><b>Tematika: Studimi i psikologjisë</b></p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me fushën e psikologjisë dhe me zhvillimin që ajo ka pësuar; me çfarë merret psikologjia dhe këndvështrimet në të cilat ajo i sheh fenomenet psikologjike; me degëzimet e psikologjisë dhe me mënyrën se si studiuesit e psikologjisë e pasurojnë diturinë psikologjike.</p>	
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë</b>
<p><b>Hyrje në psikologji</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i psikologjisë si shkencë</li> <li>- Nënfishat kryesore në psikologji</li> </ul> <p><b>Profesioni i psikologut</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mundësitë e karrierës</li> <li>- Aplikimet profesionale të shkencës psikologjike</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan nënfushat kryesore të psikologjisë;</li> <li>• përshkruan zhvillimin e psikologjisë si një shkencë empirike;</li> <li>• shpjegon rëndësinë e mirëqenies shpirtërore dhe të kujdesit që i duhet kushtuar kësaj.</li> </ul>
<p><b>Tematika: Biopsikologjia</b></p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me bazat biologjike të sjelljes njerëzore e me themelin kimik të saj, me mënyrën se si ne vihemë e mbahemi në kontakt me botën në të cilën jetojmë, me ndërtimin e aparatit që na ndihmon të kuptojmë botën me të cilën kemi kontaktuar.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me rrugët që ndjekin sinjalet që prej organeve të shqisave e deri në tru; me shqisat e të parit, dëgjuarit, shijuarit, nuhatjes, me perceptimin përkatës dhe me faktorë ndërmjetës në procesin e perceptimit.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me konceptet dhe teoritë mbi motivacionin, me motivet për të ngrënë, pirë e për sukses, me marrëdhëniet dhe hierarkinë e motiveve. Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me natyrën e emocioneve dhe teoritë që i shpjegojnë ato, me mënyrat e shprehjes së emocioneve.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me stresin, stresorët dhe reagimin ndaj tyre, me sistemin imunitar dhe sëmundjet, me marrëdhëniet midis modeleve sjellore dhe sëmundjeve të caktuara, me mbrojtjen nga stresi dhe adoptimin e besimeve dhe të sjelljeve të shëndetshme.</p>	
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë</b>

<p><b>Baza biologjike të sjelljes</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Struktura dhe funksioni i sistemit nervor</li> <li>- Struktura dhe funksioni i sistemit endokrin</li> <li>- Ndërveprimi midis faktorëve biologjikë dhe sjelljes</li> </ul> <p><b>Ndjësia dhe perceptimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Proceset e ndjesisë dhe perceptimit</li> <li>- Aftësitë dhe kufizimet e proceseve shqisore</li> <li>- Ndërveprimi i personit dhe mjedisit në përcaktimin e perceptimit</li> </ul> <p><b>Motivimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perspektivat mbi motivimin</li> <li>- Fushat e sjelljes së motivuar tek njerëzit</li> </ul> <p><b>Emocionet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perspektiva për emocionet</li> <li>- Interpretimi dhe shprehja emocionale</li> <li>- Fushat e sjelljes emocionale</li> </ul> <p><b>Shëndetësor</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Stresi dhe përballimi</li> <li>- Sjelljet dhe qëndrimet që nxisin shëndetin</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan strukturën dhe funksionim e neuronit;</li> <li>• përshkruan organizimin e sistemit nervor;</li> <li>• përshkruan strukturën dhe funksionimin e sistemit endokrin;</li> <li>• përshkruan teoritë kryesore për motivacionin;</li> <li>• argumenton nevojën për përmirësimin e funksionimit mendor;</li> <li>• harton plane për përballimin e stresit personal;</li> <li>• shpjegon reagimet fiziologjike dhe psikologjike ndaj stresorëve.</li> <li>• analizon rolin e biologjisë dhe të të nxënëit në motivacionin dhe emocionet;</li> <li>• analizon aspektet fiziologjike, afektive, kognitive dhe sjellore të emocioneve</li> </ul>
<p><b>Tematika: Zhvillimi</b></p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me ndikimin e faktorëve gjenetikë në zhvillim, me zhvillimin prenatal, me zhvillimin mendor, emocional, social gjatë foshnjërisë dhe fëmijërisë, me zhvillimin gjatë adoleshencës, me zhvillimin në moshën e rritur.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me biologjinë e motivit seksual, me faktorët socialë e kulturorë me ndikim në seksualitetin, me çrregullimet seksuale, me qëndrimet e shëndetshme seksuale.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me shkollat kryesore të shpjegimit të personalitetit: atë psikodinamike, kognitive, fenomenologjike dhe atë karakterologjike, me vlerësimin e personalitetit.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënëit</b></p>	

Njohuritë	Aftësitë
<p><b>Zhvillimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodatat dhe çështjet në zhvillimin e jetës</li> <li>- Teoritë e zhvillimit</li> <li>- Zhvillimi prenatal dhe i porsalinduri</li> <li>- Foshnjëria (d.m.th. dy vitet e para të jetës)</li> <li>- Fëmijëria</li> </ul> <p><b>Personaliteti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perspektiva për personalitetin</li> <li>- Vlerësimi i personalitetit</li> <li>- Çështjet rreth personalitetit</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan zhvillimin si proces jetësor;</li> <li>• tregon teknikat për grumbullimin e të dhënave për zhvillimin njerëzor;</li> <li>• përshkruan teoritë për zhvillimin njerëzor;</li> <li>• përshkruan mjetet në përdorim për vlerësimin e personalitetit;</li> <li>• ndërton plane për zhvillimin e personalitetit individual.</li> </ul>
<p><b>Tematika: Njohja</b></p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me kuptimin mbi vetëdijen, me gjumin dhe ëndrrat, me hipnozën dhe gjendjet që krijohen prej drogave psikoaktive.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me modelet klasike të të mësuarit: me nxënien e sinjaleve dhe të shoqërimeve (kushtëzimi klasik i Pavllorit) e me të nxënit e pasojave të sjelljes (kushtëzimi veprues i Skinnerit), me të nxënit me imitim, duke bërë, duke kuptuar. Të gjitha këto do të shihen të lidhura me sjelljen e nxënësve në kontekstin e tyre.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të marrin informacion për natyrën e kujtesës e për mënyrën se si ndodh të regjistrojmë informacion të ri, për faktorët me ndikim në punën e kujtesës, për mënyrat me të cilat mund të përmirësojmë vëllimin dhe cilësinë e kujtesës sonë e të administrojmë harresën, për bazat biologjike të kujtesës etj.</p> <p>Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me kuptimin mbi inteligjencën dhe mbi teoritë mbi të, me funksionet bazë të të menduarit; me përfaqësimet mendore e me strategjitë e të menduarit, me testimin e inteligjencës, me situatën problemore e me marrjen e vendimeve.</p>	
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	
Njohuritë	Aftësitë
<p><b>Të mësuarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtëzimi klasik</li> <li>- Kushtëzimi veprues</li> </ul> <p><b>Ndërgjegjja/vetëdija</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet midis proceseve të ndërgjegjshme dhe të pavetëdijshme</li> <li>- Karakteristikat e gjumit dhe</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan kuptimin dhe parimet e të nxënit;</li> <li>• rendit pjesët përbërëse të të mësuarit kognitiv;</li> <li>• përshkruan mënyrën si bëhet regjistrimi dhe përdorimi i informacionit të kujtesës;</li> <li>• përshkruan sistemet e kujtesës afatshkurtër e afatgjatë;</li> <li>• rendit tiparet strukturore të gjuhës;</li> <li>• përshkruan teoritë dhe stadet e zhvillimit të gjuhës;</li> </ul>

<p>teoritë që shpjegojnë pse flemë dhe ëndërrojmë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoritë e drogave psikoaktive dhe efektet e tyre</li> </ul> <p><b>Kujtesa</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Llojet e kujtesës</li> <li>- Ruajtja e kujtesës</li> </ul> <p><b>Inteligjenca</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perspektivat për inteligjencën</li> <li>- Vlerësimi i inteligjencës</li> <li>- Çështje në inteligjencë</li> </ul> <p><b>Të menduarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Elementet bazë që përbëjnë mendimin</li> <li>- Pengesat që lidhen me mendimin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan natyrën e ndërgjegjes;</li> <li>• përshkruan drogat psikoaktive dhe rolin e tyre në psikikë;</li> <li>• përshkruan natyrën e inteligjencës dhe si testohet ajo;</li> <li>• analizon marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë dhe mjedisit në diferencat individuale.</li> </ul>
--	---

**Tematika: Variacionet mes individëve e grupeve**

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me kuptimin mbi sjelljen jonormale, me shpjegimin dhe klasifikimin e sjelljes jonormale; me trajtimin e saj.

Në këtë tematikë nxënësit do të njihen me fenomenet psikologjike që aktivizohen prej të qenit në shoqëri, posaçërisht me perceptimin social, qëndrimet, paragjykimet, tërheqjen reciproke, bindjen, agresivitetin, altruizmin dhe proceset grupale.

Fokusi i kësaj tematike do të jetë sjellja e nxënësve në kontekstet e tyre tipike dhe mundësitë për të përmirësuar këtë sjellje duke zhvilluar tolerancë dhe mirëkuptim.

**Rezultatet e të nxënit**

Njohuritë	Aftësitë
<p><b>Çrregullime psikologjike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perspektivat mbi sjelljen jonormale</li> <li>- Kategoritë e çrregullimeve psikologjike</li> </ul> <p><b>Trajtimi i çrregullimeve psikologjike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perspektivat për trajtimin</li> <li>- Kategoritë e trajtimit dhe llojet e ofruesve të trajtimit</li> <li>- Çështjet ligjore, etike dhe profesionale në trajtimin e</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan karakteristikat dhe origjinën e sjelljes anormale;</li> <li>• rendit metodat e përdorura për studimin e sjelljes anormale;</li> <li>• shpjegon kategoritë kryesore të sjelljes anormale;</li> <li>• përshkruan metodat më të shquara për trajtimin e sjelljes anormale;</li> <li>• përshkruan kategoritë shoqërore dhe kulturore.</li> </ul>

<p>çrregullimeve psikologjike</p> <p><b>Ndërveprimi social</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohjen shoqërore</li> <li>- Ndikimi social</li> <li>- Marrëdhëniet shoqërore</li> </ul> <p><b>Diversiteti sociokulturor</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diversiteti social dhe kulturor</li> <li>- Diversiteti midis individëve</li> </ul>	
--	--

### **PESHA E TEMATIKAVE**

<b>Nr.</b>	<b>Tematika</b>	<b>Pesha (në përqindje)</b>
1.	Studimi i psikologjisë (7 orë)	10%
2.	Biopsikologjia (19 orë)	28%
3.	Zhvillimi (15 orë)	22%
4.	Njohja (15 orë)	22%
5.	Variacionet mes individëve e grupeve (12 orë)	18%